

Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT

### I

## MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

### PËR

## VIZITËN NË QENDRËN KORREKTUESE NË SMREKONICË

**Për:** Znj. Albulena Haxhiu, ministre  
Ministria e Drejtësisë

**Kopje:** Znj. Duda Balje, kryetare  
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe  
Peticione

Z. Habit Hajredinaj, drejtor  
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Z. Ali Gashi, ushtrues detyre  
Drejtor i përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Milazim Gjocaj, drejtor  
Departamenti për Shëndetësinë në Burgje

Z. Xhevdet Maqastena, drejtor  
Qendra Korrektuese në Smrekonicë

Prishtinë, 18 tetor 2021

## HYRJE

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKPT), bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKPT-ja, më 28 korrik 2021, vizitoi Qendrën Korrektuese në Smrekonicë (QKS). QKS-ja është institucion korrektues i tipit të hapur, ku dërgohen të dënuarit me dënime deri në tri vjet burgim dhe i nënshtrohen regjimit të hapur. Kapaciteti zyrtar i QKS-së është për 200 persona, ndërsa në kohën e vizitës ishin të akomoduar 115 të dënuar.

### Qëllimi i vizitës

Qëllimi i kësaj vizite qe vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të dënuarve, i shërbimeve shëndetësore, të cilat ofrohen për të dënuarit, si dhe i kushteve të akomodimit, në pajtim me standardet vendore dhe me ato ndërkombëtare për mbrojtjen e personave të privuar nga liria. Po ashtu, objektiv tjetër i vizitës ishte zbatimi i rekomandimeve të MKPT-së, të cilat iu dërguan Ministrisë së Drejtësisë përmes raportit me rekomandime i publikuar më 19 maj 2019.<sup>1</sup>

### Bashkëpunimi i QKS-së me MKPT-në gjatë vizitës

1. Gjatë vizitës së MKPT-së në QKS, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje të papenguar në të gjitha vendet e vizituara. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan bisedat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe pa praninë e personelit shëndetësor.

### Keqtrajtimi

2. MKPT-ja, gjatë vizitës në QKS, intervistoi një numër të të dënuarve dhe nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës të ushtruar nga zyrtarët korrektues. MKPT-ja vërejti se ekziston një klimë pozitive e marrëdhënive dhe komunikim i mirë interaktiv ndërmjet të dënuarve dhe zyrtarëve korrektues.

### Kushtet e akomodimit në QKS

3. Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) shprehimisht përcakton se i dënuari ka të drejtë në strehim, që u përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike.<sup>2</sup> Më tej ligji përcakton: "*Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar, duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra kub hapësirë dhe kur është e mundshme nëntë (9) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të vetme, si dhe të ketë sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për*

<sup>1</sup> Për më shumë shih në: <https://oik-rks.org/2019/05/21/raport-i-mkpt-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-smrekonice/>

<sup>2</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 1.

*punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.*<sup>3</sup> Për më shumë, ky ligj përcakton se lokalet nuk duhet të kenë lagështi dhe duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale.<sup>4</sup>

4. MKPT-ja vërejti se qelitë ku qëndronin të dënuarit, sa u përket madhësisë dhe ndriçimit natyral dhe artificial, në shumicën e qelive ku akomodohen të dënuarit, janë në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komiteti për Parandalim të Torturës<sup>5</sup> (KPT) dhe LESP-ja.<sup>6</sup> Përveç kësaj, pavijoni i cili deri më tani u përdor si karantinë pas paraqitjes së pandemisë COVID-19, tani është në dispozicion të të burgosurve për banim dhe do të ofrojë edhe më shumë hapësirë për banim për të burgosurit.
5. Gjatë vizitës së realizuar në QKS më 6 shkurt 2019, MKPT-ja vërejti se në katin e dytë të ndërtesës është i nevojshëm renovimi urgjent i kulmit, nga ku depërtojnë të reshurat atmosferike dhe në disa qeli vërehej depërtimi i lagështisë në tavane.
6. Lidhur me këtë mangësi, MKPT-ja, përmes raportit me rekomandime për vizitën në QKS, i publikuar më 16 maj 2019, i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që të evitohet kjo mangësi. Megjithatë, gjatë vizitës për të cilën po raportohet, u konstatua se ky rekomandim është ende në pritje për implementim.

### **Ushqimi**

7. LESP-ja përcakton të drejtën e të burgosurve për ushqim të përshtatshëm, për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tij me tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojllojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, aq sa është e mundur, kërkesave të tij fetare dhe kulturore.<sup>7</sup>
8. Më tej ligji përcakton se personi i dënuar, i cili kryen punë të rënda, personi i sëmurë, gruaja shtatzënë, ose ajo e cila ka lindur fëmijë, kanë të drejtë për ushqim të caktuar nga mjeku edhe për ushqim dietal.<sup>8</sup> Mjeku, ose eksperti tjetër për ushqim, e kontrollon ushqimin dhe para shërbimit të çdo shujte e njofton drejtorin e institucionit korrektues për cilësinë e tij dhe konstatimet i shënohen në librin përkatës.<sup>9</sup>
9. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti se kuzhina e cila përdorej për përgatitje dhe shërbim të ushqimit ishte një objekt i përkohshëm dhe se shumë shpejt do të hapej objekti adekuat për këtë qëllim dhe i cili do të ofrojë kushte dukshëm më të mira. Stafit i kuzhinës dhe të të dënuarit e angazhuar në punë në kuzhinë ishin të pajisur me librezë sanitare. MKPT-ja nuk pranoi ankesa nga të burgosurit sa u përket sasisë dhe cilësisë së ushqimit që u shërbehet.

### **Regjimi**

10. Sipas drejtorit të Qendrës Korrektuese në Smrekonicë, në përgjithësi në sezonin e verës, pothuajse të gjithë të dënuarit janë të angazhuar në punë në bujqësi, në mirëmbajtje, si

<sup>3</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 2.

<sup>4</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 3.

<sup>5</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449>.

<sup>6</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 2.

<sup>7</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39 par. 1.

<sup>8</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 2.

<sup>9</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 3.

dhe në punëtoritë të cilat funksionojnë brenda QKS-së. Përveç kësaj, brenda perimetrit të burgut ka edhe sipërfaqe me tokë bujqësore ku kultivohen kultura të ndryshme, ku të burgosurit angazhohen në punë.

11. Në dispozicion të të burgosurve është salla e fitnesit, biblioteka e pajisur me një numër të madh titujsh, dhe dhoma ku të burgosurit mund t'i kryejnë ritualet fetare në mënyrë individuale dhe grupore. Përveç kësaj, dhomat e të burgosurve janë të pajisura me TV kabllor. Të burgosurit mund të lëvizin brenda perimetrit të QKS-së gjatë tërë ditës.
12. Përmes raportit me rekomandime për vizitën në QKS, i publikuar më 19 maj 2019, MKPT-ja i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që të funksionalizoheshin punëtoritë në QKS, në mënyrë që të rritej angazhimi i të burgosurve në aktivitete të ndryshme. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti se ky rekomandim u zbatua. Në këto punëtori tani janë të angazhuar katër të dënuar, të cilët kanë aftësitë e nevojshme profesionale.

### **Kujdesi shëndetësor**

13. Neni 43 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë për shërbime shëndetësore pa pagesë. Personi i dënuar, të cilit nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues, dërgohet në spitalin e burgut, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjetër, për përkujdesje shëndetësore.<sup>10</sup>
14. Personeli mjekësor në QKS përbëhet nga një mjek i përgjithshëm i rregullt, nga ora 08:00 deri në orën 16:00, si dhe në thirrje 24 orë. Në kuadër të shërbimit mjekësor janë tre infermierë, të cilët punojnë me ndërrime nga 12 orë, dhe kryeinfermieri, i cili punon çdo ditë prej orës 08:00 deri në orën 16:00.
15. Mund të ndodhë që gjatë vikendeve të mos ketë infermier në QKS, megjithatë ata janë në thirrje 24 orë. Në dispozicion të Njesisë Shëndetësore në QKS janë edhe psikologu, psikiatri, të cilët punojnë në ditë të caktuara dhe sipas nevojës mund të angazhohen më shpesh.
16. Sa i përket infrastrukturës në dispozicion, është në nivel të kënaqshëm dhe plotëson nevojat e Njesisë Shëndetësore për të ofruar kujdesin e nevojshëm mjekësor. Njësia Shëndetësore është e pajisur me EKG, me mjetet e tjera për ndihmën e parë, me anti-shok terapi, me ultrazë (EHO), me defibrilator, me spigmomanometër, me sterilizator, me bombola oksigjeni etj. Shërbimet e tjera më të specializuara mund të ofrohen në qendrën më të afërt të mjekësisë familjare, në spitalin rajonal dhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit sa i përket ofrimit të kujdesit shëndetësor.

### **Rëndësia e kontrolleve mjekësore për të burgosurit e sapoproanuar**

17. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale<sup>11</sup> dhe Praktika Standarde e Veprimeve<sup>12</sup> e DShB-së përcaktojnë obligimin që i burgosuri i sapoproanuar t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.

<sup>10</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 43, par. 2.

<sup>11</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31.

<sup>12</sup> Praktika Standarde e Veprimeve, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Vepimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

18. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejtí se të sapopranuarit kontrollohen brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i arritjes në QKS. Kjo nënkupton një kontroll të përgjithshme, sipas Praktikave Standarde të Veprimit (PSV) të DShB-së. Ky pohim u vërtetua nga ekipi monitorues përmes kontrollit të dosjeve mjekësore dhe përmes intervistave me të burgosurit.

### **Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore**

19. Bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe me personelin shëndetësor, MKPT-ja konstaton se shërbimet mjekësore jepen në kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përveç në raste kur prania e tyre kërkohet nga mjeku.

20. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me Praktikën Standarde të Veprimit,<sup>13</sup> e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë; me LESP-në<sup>14</sup>; me standardet e KPT-së;<sup>15</sup> si dhe me aktet ndërkombëtare, siç janë: Rregullat e Mandelës<sup>16</sup> dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.<sup>17</sup>

### **Kontakti me botën e jashtme**

21. MKPT-ja konsideron se kontaktet me botën e jashtme, veçanërisht vizitat nga familja apo nga të afërmit e tjerë, janë të rëndësishme thelbësore në kontekstin e rehabilitimit social të të burgosurve.

22. Legjislacioni në fuqi,<sup>18</sup> për rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespondencë (që u nënshirohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe kanë të drejtë për një vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Sipas drejtorit të QKS-së, të burgosurit kanë të drejtë të kenë deri në 8 vizita në muaj, si dhe një vizitë ekstra bazuar në kërkesën e parashtruar në drejtorinë e QKS-së.

23. Sa u përket thirrjeve telefonike, neni 60 i LESP-së përcakton se i dënuari ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike. Të burgosurit në QKS kanë në dispozicion telefonata pa kufi, mund të komunikojnë përmes sistemit SKYPE (në dispozicion të të burgosurve janë rreth 10-15 PC).

24. Me paraqitjen e pandemisë COVID-19, pati kufizime dhe ndalim të vizitave familjare dhe vikendeve. Megjithatë komunikimi me botën e jashtme u kompensua përmes komunikimit *online* me SKYPE.

25. MKPT-ja vizitoi edhe sallën e vizitave familjare, e cila ofron kushte të kënaqshme për të pranuar vizita familjare, si dhe ofron mundësinë që i burgosuri të ketë kontakt të

<sup>13</sup> Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

<sup>14</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49.

<sup>15</sup> Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafët 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

<sup>16</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E\\_ebook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf).

<sup>17</sup> Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: [https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45\\_113.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf).

<sup>18</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

drejtpërdrejtë (nuk ka barriera ndërmjet tyre) me familjarin apo me personin nga i cili vizitohet.

### **Procedura e parashtrimit të ankesave**

26. Standardet e KPT-së theksojnë rëndësinë e sistemit efektiv të parashtrimit të ankesave dhe e konsiderojnë atë si garanci themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit.
27. Neni 91 i LESP-së përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues dhe ministri i Drejtësisë.<sup>19</sup>
28. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve në QKS gjenden kutitë e ankesave, të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) dhe ato të DShB-së. Kutitë e ankesave të vendosura nga IAP-ja mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.
29. Po ashtu, ata mund t'i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit përmes linjës telefonike pa pagesë (informatat për linjën telefonike janë të vendosura në kutitë e ankesave), përmes postës së rregullt, e cila, sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nuk i nënshtrohet kontrollit nëse i adresohet Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, si dhe përmes familjarëve të tyre.
30. MKPT-ja vërejtë se drejtori i QKS-së ofron mundësinë adekuate për parashtrim të ankesave dhe të kërkesave, i shqyrton ato dhe u dërgon përgjigje të burgosurve në këtë qendër, në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKPT-së, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

### **REKOMANDON**


#### **Ministrisë së Drejtësisë:**

- **Të rinovohet kulmi i pavijonit ku akomodohen të dënuarit.**

---

<sup>19</sup> Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: “Në ankimin e paraqitur, drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën e shkruar.”

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,  
Nam Qelaj  
Avokat i Popullit